

# KOLEGJI "BIZNESI"

Nr. 492/20 Data: 21.12.20  
PRIZREN



KOLEGJI - COLLEGE  
**BIZNESI**  
Prishtinë



## MEMORANDUM BASHKËPUNIMI

### Neni 1

Palët nënshkruese të këtij memorandumi:

1. Kolegji BIZNESI-Prishtinë, rruga "Motrat Qiriaz" nr 29 të cilën e përfaqëson Dr. Shyqeri Kabashi -Dekan, dhe
2. Academy for Training & Technical Assistance ATTA, Adresa: *Qylani vjetër nr. 2 Shadervan*. Prizren R. e Kosovës, me nr. Regj. 51109104 dhe me nr. Fiskal: 600278510

### Neni 2

Qëllimi i këtij Memorandumi

Ky Memorandum bashkëpunimi ka për qëllim përcaktimin e fushave të bashkëpunimit, kushteve dhe afatet themelore, në bazë të të cilave Kolegji BIZNESI- Prishtinë dhe ATTA-Prizren, pajtohen për bashkëpunim.

### Neni 3

Fushat e bashkëpunimit

1. ATTA - Prizren do të ndihmojë dhe mbështesë në vazhdimësi Kolegjin Biznesi, në pranimin e studentëve për realizimin e praktikës, dhe dhënjën e sygjërimeve për nevojat e ekonomisë së tregut si palë e interesit nga jashtë, të bazuar në politikat e këtij institucionit.
2. Kolegji Biznesi do të mbështesë në vazhdimësi ATTA - Prizren në aspektin e trajnimeve në fushat: **Menaxhimi i emergjencave** (mbrojtjes nga zjarrit duke kontrolluar dhe servisuar aparaturat për shuarjen e zjarrit), **Ekonomisë** (hartimin e pasqyrave financiare dhe planit të biznesit), **Juridike** (hartimi i kontratave dhe rregulloreve) dhe ngritjen e kapaciteteve profesionale të personelit në fushën e planifikimit strategjik dhe operacional.
3. Kolegji Biznesi do të mbështesë, ATTA - Prizren me stafin e sajë akademik, për ligjërata nga lëmia: Emergjencave, Ekonomisë dhe Jurisprudencës-sipas nevojave që paraqet ATTA.

#### Neni 4

#### Interpretimi dhe ndryshimi i memorandumit

1. Interpretimi i këtij Memorandumi do të bëhet në pajtim me Ligjet e Kosovës, duke e ruajtur parimin e reciprocitetit.
2. Afati i këtij memorandum është në kohë të pacaktuar. Ndryshimet dhe plotësimet e këtij Memorandumi mund të bëhen vetëm me shkrim dhe të nënshkruara nga të dyja palët.

#### Neni 5

#### Kopjet e Memorandumit

Memorandumi është punuar në katër kopje origjinale, nga dy kopje për secilën palë.


#### Neni 6

#### Hyrja në fuqi

Ky Memorandum hynë në fuqi ditën e nënshkrimit nga palët.

#### PALËT NËNSHKRUESE

Kolegji BIZNESI Prishtinë

  
/Prof. Dr. Shyqeri Kabash/  
D e k a n



ATTA

  
/Bari Zeneja/  
Drejtore Ekzekutive

© 2004 Kolegji Biznesi Prishtinë  
Kolegji Biznesi Prishtinë  
Kolegji Biznesi Prishtinë

Nënshkruar në Prishtinë, me datë 21/12 /2020